



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:020905

Datë: 21.07.2022

Numri i dokumentit: 03254455

A.nr.248/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditësit M. Th. nga Gj.me adresë në rrugën “T., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale i Republikës së Kosovës, për shkak të anulimit të vendimit nr.6002983 të datës 30.10.2020, pas seancës së shqyrtimit kryesor publik, me datë 18.07.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit M. Th. nga Gj.me adresë në rrugën “T.”

II. ANULOHET vendimi nr.6002983 i datës 30.10.2020 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale i Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt në kuptim të nenit 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësi me padinë e datës 04.02.2021, ka kërkuar anulimin e vendimit nr.6002983 të datës 30.10.2020 të marrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale i Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë. Pohon se vendimi i kundërshtuar është në kundërtënie me provat materiale në shkresat e lëndës, përkatësisht me prova mjekësore. Shton se ka probleme shëndetësore, është në gjendje të rëndë ekonomike dhe i paaftë për punë. I propozon Gjykatës që të bie Aktgjykim me të cilin aprovet padia dhe anulohet vendimi i kundërshtuar.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, paditësi deklaroi: *“Unë permanent jam nën terapi mjekësore dhe kjo mund të vërtetohet në bazë të dokumentacionit mjekësor të bashkangjitur. Padija sime i bashkangjes dokumentacionin mjekësor të ri të vitit 2022, që vërteton kërkesëpadinë time. Tani gjendja ime shëndetësore është më e keqe se më parë dhe kjo vërtetohet në bazë të dokumentacionit mjekësor. Andaj ju lutem të më aprovoni kërkesëpadinë si të bazuar me ligj”*.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare, deklaroi: *“Nga provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor por edhe nga gjendja faktike e imja pa dyshim është vërtetuar themelësia e kërkesëpadije sime, andaj gjykatës i propozoj që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoi si të bazuar dhe ta anuloi vendimin e atakuar me këtë padi si vendim të pa mbështetur në fakte dhe prova”*.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 13.05.2022 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar duke deklaruar se Komisioni Mjekësor ka konstatuar që personi nuk i plotëson kushtet në bazë të Ligjit. I propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi me numër 6002983 i dt. 30.10.2020, vendimi i dt. 10.09.202, raportet mjekësore të dt.21.09.2018, 19.09.2018, 19.11.2020, 18.11.2020, 21.11.2020, 23.07.2019, 15.01.2020, 22.07.2018, 23.06.2022,06.07.2022,24.06.2022 dhe 08.07.2022.

Gjykata shqyrtoi provat e lartcekura dhe pretendimet e paditëses lidhur me kërkesëpadinë e tij dhe gjeti se padia është e bazuar.

Gjykata nga provat e administruara, gjeti se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësi kishte aplikuar për t’ju njohur e drejta në kompensim për Persona me paaftësi të përhershme. Gjykata shqyrtoi dhe analizoi me kujdes aktin administrativ të kontestuar dhe për të njëjtin gjeti se arsyetimi është kontradiktor në raport me dispozitivin e vendimit.

Gjykata poashtu konstatoi se e paditura me vendimin e kontestuar, nuk ka trajtuar qartë pretendimet ankimore të palës paditëse, ashtu që arsyetimi i vendimit nuk korospondon me kërkesat specifike të palës paditëse dhe nuk përmban dëshmi mbi bazën e së cilave është refuzuar ankesa e paditësit.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative.

Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajnë përveç tjerash, edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e

paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj.

Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 48 të po të njëjtit Ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsytet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj.

Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërrthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku, ndër të tjera thuhet se: *“Këshilli i Ankesave si organ i shkallës së dytë me ekspert mjekësor të lëmisë përkatëse duke vepruar sipas ankesës së z.znj. M. Th. ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës në seancën e datës 20.10.2020, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit të shkallës së parë, në përputhje me paragrafin 5 të nenit 9 për PAK, dhe ka konstatuar-vlerësuar se nuk ka dokumentacion mjekësor të mjaftueshëm për të qenë përfitues i Pensionit për Persona me paaftësi të përhershme, prandaj Komisioni mjekësor i shkallës së dytë pajtohet me vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë që nuk janë plotësuar kriteret e parapara me ligj”*. Në rastin konkret gjykata gjeti se, e paditura në arsyetimin e vendimit të atakuar nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme, nuk ka administruar asnjë provë nga e cila mund të vërtetohej fakti se paditësi nuk i plotëson kriteret e parapara ligjore për të fituar statusin e personave me paaftësi të përhershme.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata konstatoi se në këtë çështje administrative-juridike është shkelur ligji në dëm të paditësit, andaj organi i paditur do të ketë parasysh theksimet nga kërkesa e paditësit.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë Aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, u mor duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 5, 6, 29, 38 si dhe nenit 46, paragrafit 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.248/2021, datë: 18.07.2022

Gj y q t a r i

Kreshnik Kaçi

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj Gjykate.